

KONTRATË SHITBLERJE TË KUOTAVE TË SHOQËRISË "DEL-CNG" SHPK

Sot, më datë 29 . 03 .2024 (dymijë e njëzet e katër), lidhet kjo Kontratë Shitblerje Aksionesh midis Palëve të mëposhtme:

1. **Znj.Nataliya PRYKHODKO**, shtetase ukrainase, lindur më 04.11.1965, në Ukrainë, banuese në Ukrainë, mbajtëse e Pashaportës me Nr. FT584037, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

referuar në këtë Kontratë si "**Shitësi**",

dhe

2. **Znj. Olena Tobolina**, shtetase ukrainase, lindur më 13.04.1973, në Rusi, banuese në Ukrainës, mbajtëse e pashaportës me nr. GA167081, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar,

referuar në këtë Kontratë si "**Blerësi**",

BAZA LIGJORE:

- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij;
- Ligji nr. 9901, Datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar.

KUSHTE PARAPRAKE:

1. **Shoqëria "DEL-CNG" sh.p.k**, është person juridik shqiptar, i regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, më datë 12.07.2023, me NIPT-M31912012M dhe ushtron veprimtarinë e saj përfshirë por pa u kufizuar, kryesisht në ndërtimin e impiantit të kompresimit të gazit, etj.
2. **Znj.Nataliya PRYKHODKO** është Ortake e Vetme e **Shoqërisë "DEL-CNG" sh.p.k**, e cila zotëron 1 (një) kuotë që përfaqëson 100% (njëqind përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.
3. **Blerësi, Znj. Olena Tobolina**, dëshiron të bëhet Ortake e Vetme e shoqërisë "**DEL-CNG**" sh.p.k dhe për këtë arsye dëshiron që të blejë nga **Shitësi**, 1 (një) kuotë që kjo e fundit zotëron tek "**DEL-CNG**" sh.p.k, që përfaqëson 100% (njëqind përqind) të kapitalit të saj themeltar.

Bazuar në sa më sipër, Palët kanë rënë dakord që të hartojnë këtë Kontratë Shitblerje Aksionesh me kushtet dhe afatet e mëposhtme:



NENI 1



OBJEKTI I KONTRATËS

- 1.1 *Shitësi* do të transferojë nëpërmjet shitjes 1 (një) kuotë që zotëron tek shoqëria “**DEL-CNG**” sh.p.k, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me NIPT- M31912012M, që përfaqëson 100% (njëqind përqind) të kapitalit themeltar të saj tek *Blerësi* Znj. Olena Tobolina, sipas Vendimit të Ortakut të Vetëm të shoqërisë, datë 23.03.2024, lidhur me këtë transferim.
- 1.2 *Blerësi* pranon të blejë 1(një) kuotë që *Shitësi* zotëron tek shoqëria “**DEL-CNG**” sh.p.k, e cila përfaqëson 100% (njëqind përqind) të kapitalit të saj themeltar, sipas vullnetit të shprehur të tij.
- 1.3 Pas këtij transferimi, pjesëmarrja në kapitalin e shoqërisë “**DEL-CNG**” sh.p.k do të jetë si më poshtë vijon:
- 1.3.1 *Blerësi* Znj. Olena Tobolina, shtetase ukrainase, shtetase ukrainase, lindur më 13.04.1973, në Rusi, banuese në Ukrainës, mbajtëse e pashaportës me nr. GA167081, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, do të zotërojë 1 (një) kuotë, që përfaqëson 100 % (njëqind përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

NENI 2

ÇMIMI I BLERJES DHE PAGESA E TIJ

- 2.1 Pjesët e sipërpërmendura, kuotat objekt shitje i kësaj Kontrate do të transferohen në vlerën nominale që përbëhet nga 10, 000 (dhjetë mijë lekë) për cdo kuotë.
- 2.2 *Shitësi* i transferon *Blerësit* 1 (një) kuotë, e cila përfaqëson 100% (njëqind përqind) të pjesëve të kapitalit, në shumën totale prej 10,000(dhjetë mijë) Lek.
- 2.3 Çmimi i kontratës do të paguhet nga *Blerësi* tek *Shitësi*, në llogarinë bankare (të dhënat e llogarisë bankare bashkëngjitur kësaj Kontrate), të këtij të fundit, në vlerën përkatëse sipas parashikimeve në këtë Nen, brenda 3 (tre) muajve nga momenti i nënshkrimit të kësaj Kontrate nga palët.
- 2.4 Palët e kësaj Kontrate bien dakord pagesa e cmimit të blerjes nuk do të jetë kusht për kalimin e pronësisë së kuotës dhe se transferimi i pronësisë së kuotës nga *Shitësi* tek *Blerësi* do të jetë efektiv që nga momenti i nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe depozitimit të saj në QKB, pavarësisht momentit të pagesës së cmimit të blerjes.

NENI 3

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

- 3.1 *Shitësi* garanton *Blerësin* se pjesët e kapitalit janë të transferueshme dhe të lira nga nga çdo lloj pengu, detyrimi, takse, pretendimi, te drejte parablerjeje, apo barre tjetër dhe asnjë person i tretë nuk ka asnjë te drejtë reale apo garancie mbi Aksionet.
- 3.2 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, *Shitësi* humbet të drejtën për të disponuar mbi kuotën që është objekt i kësaj Kontrate dhe *Blerësit* i transferohen të gjitha të drejtat e detyrimet që rrjedhin nga



këto kuota. Të gjitha të drejtat që sipas ligjit burojnë nga zotërimi i kuotës të shitur me këtë Kontratë, i transferohen *Blerësit* dhe ky i fundit bëhet titullar i vetëm dhe i ligjshëm i përqindjes së kuotave objekt Kontrate.

- 3.3 Palët e kësaj Kontrate bien dakord që kjo Kontratë të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe transferimi i pronësisë së kuotave do të jetë efektiv që me nënshkrimin dhe depozitimin e kësaj Kontrate në QKB, pavarësisht momentit të kryerjes së pagesës së çmimit të saj.
- 3.4 Blerësi fiton nëpërmjet kësaj Kontrate të gjitha të drejtat që burojnë nga zotërimi i kuotave (pjesëve të kapitalit të shoqërisë).

NENI 4 ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

- 4.1 Kjo Kontratë do të interpretohet sipas Ligjit Shqiptar. Çfarëdo çështje e cila nuk parashikohet në këtë Kontratë, do të zgjidhet sipas dispozitave të Kodit Civil të Repulikës së Shqipërisë dhe Ligjit "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar.
- 4.2 Në rast të ndonjë mosmarrëveshje që mund të lind midis palëve dhe që ka të bëjë me interpretimin, zbatimin, përfundimin e kësaj Kontrate, Palët bien dakord të bëjnë maksimumin e mundshëm për të zgjidhur çdo mosmarrëveshje në mënyrë miqësore.
- 4.3 Nëse pas përpjekjeve të arsyeshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në rrugë miqësore zgjidhja nuk arrihet për 30 (tridhjetë) ditë nga tentativa e parë për zgjidhje miqësore, atëherë palët do të drejtohen për zgjidhjen e tyre tek gjykata kompetente, jetë Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Shqipëri.

NENI 5 TË NDRYSHME

- 5.1 Kjo Kontratë është hartuar në 2 (dy) kopje origjinale, me vlerë të njëjtë ligjore, në gjuhën angleze. Kjo Kontratë do të shoqërohet me një përkthim zyrtar në gjuhën shqipe nga një përkthyes zyrtar i licensuar në Shqipëri.
- 5.2 Kjo Kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga Palët.

PALËT:

SHITËSI

Znj. Nataliya PRYKHODKO



Nataliya Prykhodko

BLERËSI

Znj. Olena Tobolina



Olena Tobolina